VENDIM
Nr.802, datë 29.9.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE, PËR SHPENZIME KORENTE, NDËRMJET PROGRAMEVE, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 "Për buxhetin e vitit 2010", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Rishpërndarjen e fondeve, për shpenzime korente, ndërmjet programeve brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si më poshtë vijon:

a) Programit të planifikimit, menaxhimit dhe administrimit t'i shtohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh.

b) Programit të mbrojtjes sociale t'i pakësohet fondi prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha